



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 si dhe nenit 13 dhe 14 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga buxheti i Komunës 15Nr. 011-23133 e datës 06.05.2015, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 1400 € (një mijë e katërqind euro), Shkollës së futbollit "Atletiko-B", sipas kërkesës së datës 02.02.2016.

Shuma e cekur në paragrafin paraprak i ndahet për ta mbështetur financiarisht për vazhdimin e garave në futboll.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2016 pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhirollogarinë bankare të Shkollës së Futbollit "Atletiko-B" nr. 1907700041031161 në Banka Kombëtare Tregtare.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëtin do të njoftohet Shkolla e Futbollit "Atletiko-B".

1Nr. 400-5095

Lipjan, më 03.02.2016

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

